



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/55  
Datë: 05.01.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 janar 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohet Plani Vjetor i Punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2012.
2. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin Legjislativ t'ia procedojë Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/55

Datë: 05.01.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1, nenit 8, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 03/1-139, për shpronësimin e pronës së paluajtshme, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/ L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 janar 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa për shpronësimin e shtëpisë në Polac numri i parcelës 600-6, zona kadastrale Polac në Komunën e Skënderajt që ndërlidhet me projektin e ndërtimit të rrugës regjionale Polac-Vushtrri.
2. Vlera e kompensimit të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse do të përcaktohet sipas kategorive përkatëse nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe do të kompensohet nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Kuvendi Komunal i Skënderajt.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/55  
Datë: 05.01.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe nenit 45 të ligjit Nr. 03/1 - 139, Datë 26.03.2009 "Për shpronësimin e pronës së paluajtshme", të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/ L-205 duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 janar 2012, mori:

**V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R**

1. Miratohen ndryshimet dhe shpronësimet shtesë në segmentin 1, 2, 3, dhe 4 për interes publik, të pronarëve dhe zotëruesve të interesit në pronat e paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës Vërmicë-Merdare, në zonat kadastrale të Komunës së Prizrenit, dhe në zonat kadastrale të Komunës së Suharekës sipas tabelave të bashkangjitura të këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Ministria e Financave, Kuvendi Komunal në territorin e se cilës kalon Autostrada në mbështetje të Ministrisë së Infrastrukturës i dërgojnë vendimin subjektivit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Ministria për Financa në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat në të cilat është e përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.



5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura te këtij vendimi.
6. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor është e detyruar të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
7. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/55

Datë: 05.01.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 janar 2012, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani Zhvillimor Strategjik për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2012-2016.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë